

Nr 125 Prot
dt. 27.11.2024

27.11.2024
P.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR SHËNDETËSINË
DREJTORIA E POLITIKAVE TË KUJDESIT PARËSOR DHE SHËNDETIT PUBLIK

Nr 3916/Prot
4

Tiranë më 21.11.2024

URDHËR

Nr. 608, datë 21.11.2024

**PËR
REFERIMIN E PERSONAVE ME ÇRREGULLIME TË SHËNDETIT MENDOR PËR
VLERËSIM TË AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE INVALIDITETIT NË PUNË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7703, datë 1.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor", i ndryshuar.

URDHËROJ:

1. Drejtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor, për vlerësim të invaliditetit në punë në Komisionin Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), bëhet sipas parashikimeve në këtë pikë.

- Drejtimi në KMCAP të ISSH-së bëhet nga Komisionet Mjekësore të ngritura për vlerësimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që janë subjekt trajtimi pranë Qendrave Komunitare të Shëndetit Mendor në rajonet në të cilat janë ngritur dhe funksionojnë këto qendra.
- Komisionet Mjekësore për drejtimin në KMCAP për personat me çrregullime të shëndetit mendor, që nuk janë subjekt trajtimi nga shërbimet e shëndetit mendor të specializuara me shtretër, funksionojnë në qendrat komunitare të shëndetit mendor.
- Komisionet Mjekësore për drejtimin në KMCAP të personave me çrregullime të shëndetit mendor, që nuk janë subjekt trajtimi nga shërbimet e shëndetit mendor të specializuara me shtretër, por nga qendrat komunitare të shëndetit mendor, përbëhen nga 3 (tre) anëtarë, mjekë të specializuar në psikiatri.
- Drejtimi në KMCAP i personave me çrregullime të shëndetit mendor, bëhet vetëm për diagnozat e përfshira në Kriteret Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë.

2. Drejtimi i pacientëve me çrregullime të shëndetit mendor, për vlerësim të aftësisë së kufizuar në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (KSHVAK), pranë strukturave të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), bëhet sipas parashikimeve në këtë pikë.

- a) Mjeku specialist psikiatër i Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor që ndjek personin me çrregullime të shëndetit mendor, plotëson formularin e mjekut specialist për të rritur / fëmijë.
- b) Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, Tiranë, me juridiksion në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, referon për vlerësim të aftësisë së kufizuar të gjithë fëmijët 0 – 18 vjeç të cilëve iu ofron shërbime multidisiplinare. Formulari plotësohet nga mjeku specialist i Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, që ndjek fëmijën.
- c) Në zonat, ku nuk ka Qendra Komunitare të Shëndetit Mendor, vlerësimi kryhet nga mjeku specialist i qendrës shëndetësore/spitalit që ndjek pacientin.
- ç) Në rastet e parashikuara në shkronjat (a) dhe (b) të kësaj pike, formulari i mjekut specialist shoqërohet me vlerësimet e psikologut dhe të punonjësit social, si pjesë e ekipit multidisiplinor të Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor.
- d) Në rastet e parashikuara në shkronjën (c) të kësaj pike, formulari i mjekut specialist shoqërohet me vlerësimet e psikologut dhe/ose të punonjësit social, të atashuar pranë institucioneve shëndetësore të zonës.
- dh) Drejtimi në KSHVAK i personave me çrregullime të shëndetit mendor, bëhet vetëm për diagnozat e përfshira në kriteret bio-psiko-sociale të miratuara me Udhëzim nr. 21 datë 07.10.2016 dhe i shoqëruar me të gjithë dokumentet që kërkohen për çdo diagnozë në kapitullin “Dëmtimet Psikiatrike” për të Rritur dhe Fëmijë.

3. Dokumentacioni për drejtimin në KMCAP / KSHVAK, të personave që vlerësohen për invaliditet në punë/aftësi të kufizuar.

- a) Drejtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor, të përcaktuar në pikën 1 të këtij Urdhri, bëhet me Fletë Drejtimi për KMCAP, pas ndjekjes të dokumentuar për një periudhë 6 (gjashtë) mujore nga shërbimet e specializuara të shëndetit mendor.
- b) Drejtimi për vlerësim të aftësisë së kufizuar i personave me çrregullime të shëndetit mendor të përcaktuar në pikën 2 të këtij Urdhri, bëhet sipas formatit “Formular i Mjekut Specialist për të Rritur / Fëmijë, të përcaktuar në VKM nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, të ndryshuar. Referimi bëhet pas ndjekjes së dokumentuar për një periudhë 6 (gjashtë) mujore nga ekipi multidisiplinor i Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor dhe Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, e vërtetuar kjo me vlerësimin psiko-social i cili shoqëron formularin e mjekut specialist.

- c) Periudha 6 mujore e ndjekjes së dokumentuar aplikohet edhe për zonat, ku nuk ka qendra komunitare të shëndetit mendor, e dokumentuar kjo me vlerësimin psiko-social, që shoqëron formularin e mjekut specialist.
- ç) Përrjashtim nga rregulli i ndjekjes së dokumentuar për një periudhë 6 mujore bëjnë rastet e mëposhtme:
- i. Personat që kanë diagnozë “Prapambetje Mendore” dhe/ose “Çrregullime Pervazive të Zhvillimit”, diagnostikimi dhe deficieti i të cilave kërkojnë vlerësim nga disa ditore në disa mujor;
 - ii. Personat me çrregullime të shëndetit mendor, rezidentë jashtë Republikës së Shqipërisë, për të cilët afati kohor i ndjekjes 6 mujore konsiderohet ndjekja e dokumentuar nga shërbimet e shëndetit mendor të vendit ku aktualisht personi i interesuar është rezident. Dokumentacioni i lëshuar nga shërbimet jashtë vendit duhet të jetë i përkthyer, origjinal ose fotokopie e noterizuar. Personi me çrregullime të shëndetit mendor vlerësohet nga Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor ose shërbimet e shëndetit mendor të specializuara me shtretër.

4. Dispozita të fundit

- a) Ngarkohet Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor në nivel qendror dhe rajonal, Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët Tiranë dhe Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” për zbatimin e këtij urdhri.
- b) Ngarkohet drejtorja përgjegjëse për çështjet e shëndetit mendor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.
- c) Urdhri nr. 20, datë 18.01.2016 për “Ngritjen e komisioneve mjekësore për drejtim në KMCAJ për të sëmurët me çrregullime të shëndetit mendor”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

